

Reformimi i Arsimit

The logo for GTZ (German Technical Cooperation) is displayed in red lowercase letters within a white rectangular box.

Profesional në Kosovë

**Trajnimi Didaktikë profesionale
Doracaku dhe fletë punuese
2006 – 2007**

prezantimi



puna në ekip

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	1
PËRMBAJTJA E FLETAVE PUNUESE	2
1 PARATHËNIE	3
2 HYRJE	4
3 KOMPETENCAT VEPRUESE PROFESIONALE	5
4 MËSIMI I ORIENTUAR NË VEPRIM	8
4.1 Aspekte të mësimit të orientuar në veprim	9
4.2 Modeli i veprimit të plotë	12
4.3 Mësimi i orientuar në porosi/detyrë	16
4.4 Metoda për mësimin e orientuar në veprim	19
4.4.1 Teknikat e moderimit	19
4.4.2 Metoda tjera kreative	25
4.4.3 Fazat e veprimit dhe metodat / Mediat (shembuj)	27
5 NGA KURRIKULI I ORIENTUAR NË QËLLIM MËSIMOR TEK SITUATA MËSIMORE E ORIENTUAR NË KOMPETENCA	28
5.1 Plani i punës/veprimit i shkollës	29
5.2 Situata mësimore	30
6 NGA SITUATA MËSIMORE NË MËSIM	34
7 SHTOJCË	
7.1 Literatura	37
7.2 Prova me fotografi	38

Përmbajtja e fletave të punës

PROGRAMI I KURSIT	A 1
1. DITA E PARË	A 2
2. DITA E DYTË	A 13
3. DITA E TRETË	A 25
4. DITA E KATËRT	A 48
5. DITA E PESTË	A 52

Të dashur mësimdhënës,

Gjatë viteve 2002-2004 është punuar intensivisht në zhvillimin e kurrikulit për shkolla profesionale në Kosovë. Për disa profile të caktuara, tani jemi në një proces të rishikimit që të kemi kurrikule të unifikuara për të gjitha lëmit profesionale. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka zhvilluar dhe vazhdon të kryej një sërë aktivitetesh që të sigurohet se mësimdhënësit janë të vetëdijshëm, e kuptojnë dhe janë në gjendje ta ligjërojnë programin e ri /kurrikulin/silabusin.


Mësimdhënësit e lëndëve teorike profesionale dhe të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e kompetencave sociale e profesionale, të plota dhe të qëndrueshme.

Elemente kryesore për arritjen e suksesit në procesin e të nxënësit, janë *planifikimi dhe organizimi i drejtë i orës mësimore dhe motivimi i nxënësve*. Që mësimdhënësi të mund të realizoj mësimin pa vështirësi të mëdha është më se i nevojshëm një planifikim (me shkrim) i mirëfilltë i orës mësimore. Një mekanizëm i fuqishëm motivimi, i cili duhet të praktikohet nga ana e mësimdhënësve dhe instruktorëve të praktikave është njoftimi i vazhdueshëm i nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre. Integrimi i *teorisë me praktikën e profesionit, "të nxënësit duke vepruar", puna në grup, puna me projekte, në përgjithësi një mësim i orientuar në veprim*, janë format bazë të organizimit të mësimin për të zhvilluar kompetencat kryesore, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe me veprimtarinë e qytetarit të ardhshëm në përgjithësi. Për mësimdhënien duhet synuar forma dhe metoda që e vendosin nxënësin në qendër të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësimdhënësit nga ligjërues i thjeshtë, në një moderator, mbikëqyrës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

Në fund mësimdhënës të dashur, besojmë se me ofrimin e një doracaku për didaktikë profesionale, i cili ka një përmbajtje më të avancuar dhe është një vazhdimësi e trajnimit paraprak në bazat e metodologjisë së mësimdhënies, do të keni një orientim të mirë për të zhvilluar me kreativitet idetë tuaja mësimdhënëse.

Ky doracak është përgatitur nga Eksperti Gjerman z. Uwe Graune me përkrahjen financiare të Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Teknik GTZ, Projekti "Reformimi i Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë".

Ju dëshirojmë sukses në punën tuaj!



Agim Bërdynaj, MASHT,
Udhëheqës i Departamentit për Arsim Parauniversitar

Prishtinë 08.06.2007

Ky trajnim njëjavor u ofrohet mësimitdhënësve dhe instruktorëve të shkollave të mesme profesionale. Këto masa mbi zhvillimin e kuadrit shërbejnë për zhvillimin e mësimit dhe duhet të renditen tek aftësimet e mëtejme didaktiko-profesionale. Ky doracak ka dy pjesë (udhëzuesin dhe fletat e punës) dhe pranë prapavisë teorike në rend të parë qëndron praktika në mësim, për këtë arsye ky doracak do duhej të kuptohej si një plotësim për mësimin sot.

Shumica e mësimitdhënësve dhe instruktorëve në shkollat e mesme profesionale posedojnë njohuri solide teorike-profesionale, shkathhtësi praktike-profesionale si dhe përvojë pune shkollore dhe jashtëshkollore. Pranë kursit të parë për didaktikë profesionale, këto janë parakushte të rëndësishme për një pjesëmarrje të suksesshme.

Detyra e shkollës së mesme profesionale, zhvillimi i kompetencave vepruese profesionale të nxënësve është çështja kyçe e këtij kursi. Për këtë arsye edhe pyetja thelbësore e këtij kursi është:

Çfarë kompetenca u nevojiten nxënësve për tregun e punës sot dhe në të ardhmen?

Cilat koncepte dhe metoda mësimore nxisin kompetencat vepruese profesionale?

Si mund të shndërrohen kurrikulet e reja të hartuara bazuar në lëndë në një mësim të orientuar në kompetenca në një shkollë profesionale?

Si mësimitdhënës dhe kolegë jeni të ftuar të përcillni te autori komentet, sugjerimet dhe idetë tuaja.

Uwe Graune post@u-graune.de


Sugjerim:

Publikoni të gjitha materialet në internet të cilat janë relevante për mësim. Kjo përmbledhje idesh nuk nxitë vetëm zhvillimin e mësimit por gjithashtu mund të reduktojë kohën e parapërgatitjeve për mësim.

Kompetencat vepruese profesionale

3 Kompetenca vepruese profesionale

Profesione dhe kërkesa industriale dhe zejtare i nënshtrohen një ndryshimi dhe zhvillimi permanent, siç vërehet në veçanti në lëmin e TI. Me këtë ndryshojnë edhe kërkesat ndaj profesionistit dhe kualifikimeve të tij. Përderisa më herët ky profesionist arsimohej sipas „nevojës“ dhe përshtatej në „shabllonet profesionale“, sot në rend të parë qëndron zhvillimi i kualifikimeve kyçe (fig.1.1.) që të mund të përcillen ndryshimet e vazhdueshme. Me këtë kuptohet se profesionisti duhet ti përgjigjet kërkesave të vazhdueshme për kualifikime të mëtejme, duke qenë në gjendje të aktivizoj jo vetëm njohuritë profesionale por edhe njohuri gjithëpërfshirëse për të zgjedhur problemin në mënyrë të pavarur. Përveç kësaj duhet të jetë i kualifikuar dhe i aftë për ekip, të paraqet zgjidhje në mënyrë shoqërore-integrative dhe të merr përgjegjësinë për veprimet e tija.



1: Aftësia profesionale për veprim

Kompetencat vepruese profesionale

Mirëpo pikërisht kualifikimet kyçe gjithëpërfshirëse (fig. 2) si fleksibiliteti, pavarësia ose kreativiteti nuk mund të nxiten shumë në mësimin klasik. Detyrë e mësimin të orientuar në veprim (MOV) është pra zhvillimi i kompetencave vepruese profesionale tek nxënësit.



2:Kualifikime gjithëpërfshirëse (jashtë fushës profesionale)

Me kompetencë vepruese profesionale nënkuptohet aftësinë dhe gatishmërinë e një individit që në situata profesionale të veproj në mënyrë profesionale, duke menduar vet dhe në përgjegjësi të shoqërisë, d.m.th. problemet e pritshme ti zgjidhë në mënyrë të pavarur orientuar në bazë të shemave të veprimit, të vlerësoj zgjidhjen e gjetur dhe të zhvilloj më tutje repertorin e veprimeve individuale. Kompetenca vepruese zbërthehet në dimensionet e kompetencave profesionale, personale dhe atyre sociale.

Kompetencat vepruese profesionale

Kompetenca profesionale përshkruan gatishmërinë dhe aftësinë për të zgjidhur detyrat dhe problemet bazuar në njohuritë dhe shkathtësitë profesionale duke i orientuar kah objektivat, profesionalisht, sipas metodave dhe në mënyrë të pavarur por edhe të vlerësoj rezultatet.

Kompetenca personale përshkruan gatishmërinë dhe aftësinë, që si personalitet individual të qartësoj, të mendoj mirë dhe të vlerësoj mundësitë e zhvillimit, kërkesat dhe kufizimet në familje, punë dhe jetë publike, t'i shpalosë dhuntitë personale si dhe të krijoj dhe zhvilloj më tutje planet jetësore. Kjo kompetencë përfshinë attribute personale si pavarësinë, aftësinë për të kritikuar, vetëbesimin besueshmërinë, vetëdija për përgjegjësi dhe obligime. Në veçanti përfshin edhe zhvillimin e vlerave të paramenduara mirë paraprakisht si dhe lidhjen e caktuar vetë në vlera.

Kompetenca sociale përshkruan gatishmërinë dhe aftësinë, për të krijuar dhe jetuar marrëdhënie sociale/shoqërore, të kuptojë ngrohtësinë dhe tensionimet, si dhe të diskutoj dhe të kuptohet me të tjerët në mënyrë racionale dhe me përgjegjësi. Këtu në veçanti hyn edhe zhvillimi i përgjegjësisë sociale dhe solidaritetit.

Kompetenca metodologjike, K. komunikative dhe K. e nxënies janë pjesë integrale të kompetencës profesionale, personale dhe sociale. Kompetenca metodologjike është aftësia dhe gatishmëria e veprimit të planifikuar dhe të orientuar kah objektiva gjatë shqyrtimit të detyrave dhe problemeve profesionale. Metoda të të menduarit dhe proceset e punës përzgjidhen, aplikohen në mënyrë të pavarur e pjesërisht edhe zhvillohen më tutje. Kompetenca komunikative nënkupton gatishmërinë dhe aftësimin për të kuptuar dhe krijuar situata komunikative. Në këtë rast duhet perceptuar, kuptuar dhe paraqitur synimet dhe nevojat vetanake dhe të partnerit. Kompetenca e nxënies është aftësia dhe gatishmëria, për të marrë informata në mënyrë të pavarur (p.sh. vlerësimi i artikullit profesional). Në këtë rast vlen shumë aftësia për përdorimin e strategjisë dhe teknikës së nxënies, si dhe gatishmëria për të mësuarit të vazhdueshëm – si në fushën profesionale ashtu edhe në fusha jashtë profesionit.

4 Mësimi i orientuar në veprim

Objektivë e mësimi të orientuar në veprim është aftësimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve duke i aktivizuar ata dhe përmes përpunimit të pavarur të njohurive profesionale dhe atyre gjithëpërfshirëse, për t'ju afruar gradës së kompleksitetit dhe abstraksionit e cila tek shumë profesioni është gjithnjë në rritje.

Për këtë arsye mësimi i orientuar në veprim potencon tërësinë. Gjatë kësaj merren parasysh aspektet në vijim :

1. Aspekti personal: nxënësi duhet nxitur në tërësi (Koka, zemra, dora, të gjitha shqisat).
2. Aspekti përmbajtësor: Përmbajtjet mësimore përzgjidhen në bazë të rrethanave sistematike e jo për shkak të sistematikës së transmetimit/përcjelljes
3. Aspekti metodologjik: metodat e mësimi duhet të jenë të tërësishme, pra punë individuale, punë në grupe, punë me projekte etj.


Për shkak të orientimit në objektivë rezulton krijimi i produkteve vepruese. Këto mund të jenë edhe kognitive si një fazë planifikuese.

Mësimi i cili i përmbush detyrat e lartëpërshkruara, duhet të marr në përgjegjësi nxënësit që nga fillimi në të gjitha fushat organizative dhe për këtë duhet emëruar si „mësim aktiv për nxënë“. Kjo nënkupton që një nxënë varësisht nga rrethanat edhe mund të formuloj vet objektivin e tij veprues.

Mësimi i orientuar në veprim

4.1 Aspekte të mësimimit të orientuar në veprim

Aspektet e mësimimit të orientuar në veprim (fig.3) arsyetohen përmes teorive sociale-psikologjike dhe kognitive-psikologjike për veprim dhe zhvillim. Nga këto rrjedhin tipare të përgjithshme për mësimin e orientuar në veprim, për të cilat do të diskutojmë në vazhdim.



3: Aspekte të mësimimit të orientuar në veprim

I orientuar në objektiv

Bazë e çdo mësimi të orientuar në veprim është formulimi i një objektive vepruese. Detyrë e tij është të jetë faktorë motivues gjatë gjithë njësisë mësimore. Çdo veprim tjetër rezulton nga formulimi i parë i objektivit, meqë mungojnë njohuritë vepruese. Në bazë të një problemi të paraqitur nxënësit duhet të vetëdijesohen se atyre u mungojnë njohuritë vepruese.

Mësimi i orientuar në veprim

Paraqitja e një situatë problematike dhe formulimi i qëllimit i cili rezulton nga kjo situatë, duhet të mendohen dhe tematizohen me shumë rëndësi në kuadër të mësimi të orientuar në veprim. Nxënësit duhet të kenë mundësinë të identifikohen me qëllimet, që të mund të punojnë të orientuar në qëllim dhe të motivuar. Pikërisht kjo shpeshherë është problematike tek qëllimet e formuluar nga mësimdhënësit, meqë në mes të paramendimeve dhe përvojave të tyre përcillet një „grupë“ gjenerative dhe profesionale. Ndhimesë për një formulim kuptimplotë të qëllimit mund të jetë një referim në profesion, situata të veçanta, referim në situata problematike dhe rëndësia për të ardhmen..

Lidhur me subjektin

Mësimi i orientuar në veprim duhet nxitur nxënësit për të shtruar pyetje. Ata duhet të mendojnë për rëndësinë e detyrës, se cilat shkathtësi dhe njohuri u nevojiten dhe se ka do të thotë për ata zotërimi i detyrës. Parë nga pikëpamja didaktike edhe nxënësve u mundësohet përfshirja në planifikimin mësimor/e të nxëniti dhe mundësimi i përcaktimit të kohës individuale për të mësuar.

Tërësia

Në mësimin e orientuar në veprim, depërtimi intelektual dhe kuptimi sensual i një situatë vepruese krijojnë një njësi. Moment i rëndësishëm i krijimit të tërësishëm të mësimi është mundësimi i interaksioneve të shumëllojshme dhe të orientuara në rezultate në situata sa më të natyrshme të mundshme. Mësimi i orientuar në veprim, si një proces sistematik sjell një mënyrë të ecurisë në formë integrative dhe gjithëpërfshirëse.

Lidhur me objektin

Ndikimet e veprimeve mësimore bazohen gjithmonë në një objekt mësimor – p.sh. një objekt teknik ose një proces teknik – të cilin duhet kuptuar, ndryshuar gjegjësisht krijuar. Objekte mësimore mund të jenë të natyrës materiale apo jo materiale.


Mësimi i orientuar në veprim

Të menduarit sistematik

Mësimi i orientuar në veprim synon nxitjen e të menduarit sistematik dhe kuptimit të ndërvarësisë. Me 'sistematike' nënkuptohet një formë dinamike, aktive e e rrjetëzuar e të menduarit dhe veprimit. Mësimi sistematik ka parasysh dhe tematizon raportet e/në mes të sistemeve të përfshira në mësim. Ai u mundëson nxënësve të menduarit dhe veprimin në procese. Gjatë zgjidhjes së detyrave gjegjësisht proceseve, pranë aspekteve përmbajtësore teknike dhe matematiko-shkencore merren parasysh edhe si p.sh. shkenca e punës, të ekologjisë dhe ekonomisë. Në pasqyrën e objektit mësimor, pranë strukturës së përgjithshme bëjnë pjesë edhe faktorët ndikues dhe varësitë.

Struktura e veprimit

Bazuar në formulimin e qëllimit, tek mësimi i orientuar në veprime fillimisht planifikohen veprimet, pastaj zbatohen, kontrollohen në mënyrë vetanake (fig.4) dhe përfundimisht vlerësohen për detyra të tjera.




4: Veprimi i kompletuar

Sa më kompleks që është qëllimi i përgjithshëm, aq më i vështirë është përshkrimi me modele veprimi njëdimensionale. Një mundësi e zgjidhjes qëndron në formulimin e mikroqelizave, përpunimi i të cilave në makroqeliza shpie në formë të qëllimit veprues. Se sa shpejtë arrihen makroqelizat gjatë kësaj, varet nga kompetenca e veprimit..

Mësimi i orientuar në veprim

4.2 Modeli i veprimit të kompletuar

Ky model (fig. 5) paraqet në mënyrë tipike një veprim të plotë pune, është i ndarë në 6 shkallë dhe nuk do të duhej të ngatërrohej me fazat e veprimit praktik në ushtrimin e profesionit.



5: Modeli i veprimit të kompletuar


Informimi

Nxënësit dhe nxënëset kuptojnë një detyrë të ndërlikuar ose problem, analizojnë p.sh. rrethana në ndërmarrje (fig.6) pse përshkruajnë gabime gjegjësisht pengesa. Marrëveshja për një qëllim veprimi gjegj. qëllim mësimor u ofron nxënësve hapësirë për pjesëmarrje. Patjetër se është legjitime kur mësimdhënësi përcakton qëllimin, kur situata mësimore, të dhënat kurrikulare gjegj. kërkesat profesionale kufizojnë pjesëmarrjen.

Mësimi i orientuar në veprim

Planifikimi

Nxënësit dhe nxënëset planifikojnë sigurimin e informatave, ata krijojnë një plan pune dhe një plan kohor për ecurinë në mësim dhe mendojnë edhe forma tjera të punës. Format e dokumentimit dhe prezantimit si dhe kriteret për vlerësim/kontrollim duhet diskutuar paraprakisht. Numri i alternativave për planifikim mund të kufizohet pak a shumë nga mësimdhënësi përmes përzgjedhjeve dhe vendimeve paraprake bazuar në aftësitë dhe njohuritë e nxënësve dhe nxënësve.



6: Analiza e sistemit përmes skemës së teknologjisë

Vendimmarrja

Në plenar ose në grupe pas krijimit të një ose më shumë planeve gjegj. koncepteve për zgjidhje pason vendimmarrja për një mënyrë të zgjidhjes, kohën, përgjegjësitë, forma të mundshme të prezantimit, dokumentimit dhe produktin veprues.


Mësimi i orientuar në veprim

Zbatimi

Nxënësit dhe nxënëset zakonisht punojnë në grupe dhe kryejnë planifikimin. Ata sigurojnë dhe përpunojnë informacionet, përpilojnë rezultatet, dokumentojnë procesin e punës dhe rezultatet e punës së tyre. Sigurimi dhe përpunimi i informatave, në veçanti lidhur me prapavitë teknologjike dhe varshmëritë bazike, gjithsesi mund të përfshijë më shumë faza të mësimit të fokusuar në mësimdhënësin, të orientuara në varshmëri sistematike profesionale.

Kontrollimi

Nxënësit dhe nxënëset përshihen p.sh. me ndihmën e katalogëve të kritereve në një masë të mjaftueshme në kontrollimin dhe vlerësimin e mënyrave të punës, prezantimeve dhe rezultateve të punës gjegj. produktet vepruese. Duke përfshirë edhe sjelljet në punë, ata vlerësojnë proceset dhe rezultatet në mënyrë (vetë-) kritike.



7: Reflektimi i ecursisë së veprimit

Mësimi i orientuar në veprim

Forma vlerësuese për punën në grupe
--

Grupi / Tema:

Nxënësja/ Nxënësi:

1. Aktivitetet kryesore

Puna				
1	2	3	4	5

2. Vetitë dhe mënyra e sjelljes

• Angazhimi në punë
• Kujdesi
• Aftësia për ekip
• I/e gatshëm për të ndihmuar
• Kreativiteti
• Aftësia e koncentrit

Iartë.....ulët

3. Vërejtje shtesë

4. Vlerësim përmblendhës

Hapur më: _____

Pranuar më, me /pa pajtim
(të fshihet ajo që nuk përket)_____
(Vlerësuesja / Vlerësuesi)_____
(Vlerësuesja / Vlerësuesi)

8: Fletë pune – Reflektim i punës në grupe

Mësimi i orientuar në veprim


Vlerësimi

Gjatë këtij vlerësimi të ecurisë në tërësi (fig.7) bëhet fjalë për një krahasim me qëllimin veprues dhe/ose mësimor të formuluar në fund të fazës informative. E rëndësishme është se bëhet fjalë për një reflektim në rend të parë nga pikëpamja e pjesëmarrësve dhe pjesëmarrëseve për vetveten: për procesin e mësimin, fitimin e informatave, kontributin në grup (forma e vlerësimin, fig. 8).

4.3 Mësimi i orientuar në porosi

Për të iniciuar një veprim komplet është e nevojshme të shtrohet një detyrë me komplekse me përmbajtje problematike, për të cilën është i nevojshëm një angazhim i madh për planifikim.

Në mësimin në shkollat profesionale, një objekt mësimor është kuptimplotë nëse i përgjigjet fushës profesionale të nxënësve. Nxënësit duhet të krijojnë një raport me problemet dhe të zotërojnë kuptimin e veprimeve profesionale në të ardhmen.



9: Porosia e klientit në mësimin e orientuar në veprim

Objekti mësimor përmban dy përparësi. MOV duhet të nxisë të menduarit sistematik. Ky rezulton përmes shikimit në tërësi nga raporti me objektin. Përparësia e dytë qëndron në formulimin e qëllimit.

Mësimi i orientuar në veprim

Veprimi i orientuar në porosi involvon një qëllim në kuptimin klasik, i cili përmes formulimit të tij motivon nxënësit për zbatimin e veprimit. Një ndihmesë gjatë zbatimit të detyrës/porosisë është se nxënësit marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre. Me marrjen e porosisë ata futen në një nivel (të krijuar artificialisht) të përgjegjësive. Ata nuk kryejnë detyrën për vete apo për mësimdhënësin, por për një porosidhënës (virtual) të jashtëm. Identifikimi i nxënësve me këtë parim rrallë ndodhë plotësisht dhe duhet munduar që të aktivizohet gjithëherë në momente të reja.

Porosia nga klienti (fig.9, fig.10) duhet pra të përmbaj të gjitha të dhënat e përmbushjes së detyrës, që të krijohet raporti me profesionin: shkresa e porosisë (fig.11), libri i obligimeve, zbatimi në „Firmë“, dokumentimi me udhëzimet e përdorimit, produkti veprues dhe dorëzimi tek klienti.

1. Faza e informimit – Kontaktimi

Plani i ndërtimit/skica e ndërtimit
Koha dhe termini
Vërtetimi i ofertës, dëshirat e klientit

2. Krijimi i ofertës – dorëzimi i ofertës

Oferta instalimi bazik
Oferta mjetet e punës

3. Përgatitja për punë

Bisedat në vendpunim
Plani i instalimeve
Sigurimi i materialit

4. Zbatimi i detyrës

Lidhjet dhe mjetet e punës
– Instalimet bazë
Kontrollimi ndërkohë

5. Faza kontrolluese – kryerja e detyrës

verifikimi / kontrollimi finale / E-Check
Masat – instalimi i tërësishëm
Dorëzimi dhe biseda përmbyllëse

6. Barazimi i llogarisë

Kalkulimi përfundimtar
Fatura
Garancioni

7. Shërbimi i klientëve

Ruajtja e kontakteve
Pyetje: të kënaqur?

10: Shembull i një porosie nga klienti – instalime elektrike

Mësimi i orientuar në veprim

Përmes librit të obligimeve është i nevojshëm një planifikim paraprak i hapave të veprimit, të cilët përshkruajnë një pjesë të qëllimit për përmbushjen e qëllimit makro të cilin e përmban shkresa e porosisë. Formulimin i qëllimeve mikro dhe disenjimin e mënyrës së veprimit nxënësit mund ta organizojnë vet apo edhe me ndihmën e mësimdhënësit. Gjatë kësaj, të menduarit dhe të vepruarit duhet të krijojnë një njësi

Elektro Meier
Lochstr. 17
31275 Meirinen
07132 25334
Chef@Bohr-Rain.com

Elektro Meier - Lochstraße 17 - 31275 Meirinen

Fa.
Schnellfertig
Longus-Straße 13

31275 Lehrte

Instalimi i banjos

Meirinen, 18. nëntor 2008

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

për shkak të një zjarri në Mülheimerstrasse 8 duhet të sanohet e gjithë banesa kolektive.

Ju lutemi të caktoni një takim me mua në mënyrë që të mund ti shihni vendëpunimet. Me këtë rast do të jem në dispozicion për pyetje, pasi që për fat të keq shumica e dokumenteve kanë humbur gjatë zjarrit. Ato që ende gjenden do tua dorëzoj juve.

Më tregoni menjëherë për kohën e përfundimit dhe si ose me cilat mjete dëshironi ta kryeni porosinë.

Përsëndetje miqësore



Dr. Ing. B. Meier
- Drejtor

11: Mësim i orientuar në detyrë – shkresa e klientit

Mësimi i orientuar në veprim

Nxënësi pra duhet të bëj planifikimin në mënyrë të pavarur dhe sipas mundësive të zbatoj dhe kontrolloj vetë atë. Përmbyllja e njësisë së orientuar në porosi dhe veprim, në parim duhet të tejkaloj kontrollimin dhe vlerësimin. Në vend të protokollit ose të një dokumentimi të shkurtër të projektit mund të bëhet p.sh. një dokumentim i plotë me përshkrimin e funksionit, planet, format me shënime, udhëzuesin për përdorim, sugjerime për përmirësime. Përmes kësaj gjatë dorëzimit të produktit në vazhdim tek klienti rikrijohet një obligim për klientin.

4.4 Metodat e mësimi të orientuar në veprim

Mësimi i orientuar në veprim është një koncept didaktik, i cili i kufizon strukturat sistematike profesionale dhe të veprimit. Mund të realizohet përmes metodave të ndryshme të mësimi.

4.4.1 Teknikat e moderimit

Teknikat e moderimit përdoren sot gjithnjë e më shpesh; qoftë gjatë diskutimeve në radio dhe televizion apo edhe në takime në ndërmarrje – ato janë prezente. Pothuaj gjithnjë kur takohen njerëz dhe diskutojnë në mes vete atëherë është prezent një koordinator i diskutimit, Moderatorin. Ai drejton procesin e grupit dhe mundohet të optimoj bisedën me teknika të ndryshme. Si specialist i metodave mundohet ai që përmes metodave të ndryshme të nxjerrë rezultatet më të mira të mundshme.

Mësimi i orientuar në veprim

Përparësitë e teknikave të moderimit të mësimi i orientuar në veprim potencohen në raport me aspektet e mësimi të orientuar në veprim:

Drejtuar kah qëllimi

- Teknikat e moderimit ndihmojnë përcaktimin e qëllimeve (p.sh. Brainstorming me pyetje me më shumë pikë).
- Teknikat e moderimit (p.sh. plani i ecurisë & plani i projektit) shpijnë hap pas hapi tek qëllimi i përcaktuar, pa e humbur në ndonjë moment nga sytë.
- Bazuar në objekt
- Me ndihmën e teknikave të moderimit mund të përzgjidhen objektet mësimore (p.sh. Brainstorming, Matrica).
- Përmes teknikave të moderimit mund të paraqiten procese (p.sh. plani i ecurisë).

Strukturuar sipas veprimit

- Teknikat e moderimit plotësojnë fazat e mësimi të orientuar në veprim

sistematike

- Teknikat e moderimit (matrica e teknologjisë, skema e ecurisë; paraqitja e procesit) nxisin të menduarit sistematik.
- Teknikat e moderimit (p.sh. Brainstorming, pyetja me karta, etj.) nuk i kufizojnë aspektet përmbajtësore.
- Rrjetimi mund të paraqitet në mënyrë grafike (p.sh. ndryshimi radhitjes dhe lidhja e kartave përmes shigjetave).
- Teknikat e moderimit janë aktive dhe dinamike (p.sh. urdhërimi ose plotësimi gjatë pyetjeve me karta)

Mësimi i orientuar në veprim

në tërësi

- Teknikat e moderimit nuk përjashtojnë teknika/metoda tjera, ato plotësojnë dhe me këtë nxisin një zgjedhje të metodave në tërësi (p.sh. përcaktimi i kriterëve me matricë për një lojë me rrole).
- Teknikat e moderimit mundësojnë një interaksion të shumëllojshëm dhe të orientuar në rezultate..

Bazuar në subjekt

- Përmes teknikave të moderimit mund tu paraqiten nxënësve gjërat e rëndësishme (Matrica.; raporti me jetën dhe profesionin).
- Teknikat e moderimit nxisin aktivitetin e nxënësve dhe mundësojnë përcjelljen e përvojave të nxënësve në mësim (p.sh. Brainstorming, Matrica, etj.)
- Teknikat e moderimit nxisin nxënësin të mendoj për aftësitë dhe njohurit e tija (p.sh. plani i aktiviteteve).

Një rezultat nuk nënkupton automatikisht edhe një zgjidhje (p.sh. mund të paraqiten probleme të reja ose edhe nuk ka zgjidhje). Për cilësinë përmbajtësore përgjegjësinë e bartë vet grupi. Moderatorin mbështet grupin në këshilla dhe vepra, mirëpo asnjëherë nuk jep ndonjë udhëzim konkret dhe siguron që grupi të jetë dhe të mbetet i aftë për punë.

Në vitet e fundit teknikat e moderimit kanë hyrë edhe në përditshmërinë e shkollave profesionale. Ato ndihmojnë mësimdhënësit në kryerjen e detyrës, për të përcjellë kompetencat vepruese profesionale. Roli i mësimdhënësve të mësimi i orientuar në veprim duhet të zhvillohet në drejtim të moderimit dhe këshillimit për proceset mësimore.

Mësimi i orientuar në veprim

Në krahasim me rolin tradicional të mësimdhënësit si „mësues“, tek mësimi i orientuar në veprim, roli i mësimdhënësit pëson një ndryshim fundamental. Ai vë në dispozicion arranzhmanin mësimor. Në mësimin modern, mësimdhënësi mundëson të mësuarit, ai është organizator, këshilltar dhe moderator defenziv.

Një moderator do të duhej të zotëronte disa teknika të moderimit dhe ti përdor ato jo vetëm sipas planit por edhe në mësim varësisht nga situata.

Disa teknika të moderimit do të duhej ti shtjellonim në cilësi të shembujve:

Matrica

Matrica është gjithnjë atëherë e përshtatshme (fig. 12), kur ndërlidhen të dhënat në mes vete. Nga matrica e krijuar mund të fitohen njohuri, të cilat mund të shprien tek zgjidhjet. Një matricë tipike për mësimin teknik është një matricë krahasuese e teknologjisë.

Zgjidhja	Teknologjia	Ekologjia	Ekonomia
Teknologjia e vjetër	<ul style="list-style-type: none"> • Kabllot • Lidhjet në prizë • Relejet • Lidhjet e transistorit • Ndërprerës mekanik 	<ul style="list-style-type: none"> • Pesha ↑ • Lënda djegëse ↑ • Emisionet e materieve dëmtuese ↑ • Materiali ↑ • Ndotja e ambientit ↑ 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjasat për prishje ↑ • Mirëmbajtja ↑ • Shpenzimet e prodhimit ↑ • Shpenzimet për personel ↑ • Pajisje diagnostifikuese ↓ • Shpenz. e personelit ↑ • Siguria e vozitjes ↓ • Komoditeti gjatë vozitjes ↓
Teknologjia e re	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja në rrjet • Bus; CAN etj • Përçues të valëve të dritës • Multiplex • Pjesë dhe grupe ndërtimi elektronike 	<ul style="list-style-type: none"> • Pesha ↓ • Lënda djegëse ↓ • Emisionet e materieve dëmtuese ↓ • Materiali ↓ • Ndotja e ambientit ↓ 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjasat për prishje ↓ • Koha për mirëmbajtje ↓ • Interv. për mirëmbajtje ↓ • Shpenz. E prodhimit ↓ <ul style="list-style-type: none"> • Sensorët ↓ • Lidhje bakri ↓ • Priza ↓ • Personeli profesional ↑ • Shpenz. personelit ↓ • Pajisje diagnostifikuese ↑ • Siguria në vozitje ↑ • Komoditeti gjatë vozitjes

12: Krahasimi i teknologjisë

Mësimi i orientuar në veprim

Varësisht prej kohës dhe njohurive paraprake të nxënësve mësimdhënësi jep një matricë; kriteret për matricën zhvillohen në klasë ose në grupe. Puna në mësim është e mundshme pa ndonjë mundim të madh, meqë një matricë mund të krijohet në folje ose në tabelë.

Tema:	Grupi punues:		
1) Çka duam të arrijmë?			
2) Çka duhet bërë?	Kush?	Kur?	OK?
1.			
2.			
3.			
3) Çka na duhet për punën tonë?			

13: Matricë planifikimi për nxënësin

Plani i aktiviteteve

Plani i aktiviteteve synon një plan konkret të aktiviteteve, të mënyrës së punës, dhe përcaktimin e përgjegjësisë. Karakteristike për një plan aktiviteteve janë pyetjet: kush, çka, kur, me çka, përse (qëllimi). Varësisht prej grupit mësimdhënësi mund të lë nxënësit të zhvillojnë një plan ose të përdorë një planë të konstruktuar paraprakisht (fig.13)

Mësimi i orientuar në veprim

Një plan mund të paraqitet edhe me mediat e vjetra. Mund të përdoren edhe medime më të reja (shumëllojshmëri e mediave), por nuk është e domosdoshme. Një fushë e përdorimit do të ishte p.sh. në diagnostifikim – pyetje tipike në teknikën e matjeve do të ishin:

1. Cilat gabime mund të paraqiten ?
2. Si / me çka mund të gjejë gabimin?
3. Si e evitohet gabimin?

Plani i ecurisë

Proceset e zgjidhjes së problemit mund të paraqiten qartë përmes planit të ecurisë. Planet e ecurisë janë të bindshme kur bëhet fjalë për punë të strukturuar dhe orientuar kah qëllimi.

Pyetja me kartela

Pyetja me kartela është një nga metodat e moderimit që përdoren më së shpeshti në shkollë. Për të filluar një temë të re mund të fitojmë përshtypjet e para mbi objektin mësimor dhe njohuritë paraprake të nxënësve. Për të mbledhur tema, pyetje, ide, mundësi zgjidhjesh, shërben kjo metodë. Në këtë rast vlenë mënyra e ecurisë:

Çdo nxënës shënon mendimet e veta lidhur me një pyetje në një kartë (vetëm një mendim, e shkruan me të mëdha dhe lexueshëm).

Të gjithë nxënësit paraqesin mendimet e tyre dhe i ngjeshin ato në tabelë (në murë apo i vendosin në tokë etj.). Mendimet e dyfishuara vendosen së bashku.

Në më shumë procese të seleksionimit të thënieve të ngjashme gjegjësisht me kuptime të njëjta u vihet nga një nocion kryesor

Mësimi i orientuar në veprim

Në fund vendosë klasa se në cilat komplekse do të punoj më tutje. Mënyra e punës është një pikë tjetër diskutimi.

Rezultati i të pyeturit përmes kartave në të shumtën e rasteve do të duhej të ishte një udhëzim për ecurinë e mëtejme. Ndarjet e ndryshme nxënësit mund ti bëjnë njëkohësisht ose duke ndarë punën. Nëse një njësi është përpunuar me sukses, atëherë për arsye motivuese kjo do të duhej të vizualizohej.

4.4.2 Metoda tjera kreative

Metoda e tophit të borës


Metoda e tophit të borës është një proces i shkallëzuar i Brainstorming, me qëllim të mbledhjes së pyetjeve/problemeve, ideve/zgjidhjeve lidhur me një temë. Pjesëmarrësit shkëmbejnë dhe dakordojnë qëndrimet e tyre nëpër grupe të ndryshme. Në fund qëndron një zgjidhje/përgjigje, vendosur nga të gjithë pjesëmarrësit. Nocioni „metoda e tophit të borës“ qëndron, sepse me këtë metodë shpreshtohen gjithnjë e më shumë idetë individuale përmes grupeve punuese. Kjo metodë synon zgjerimin e kompetencave sociale dhe komunikative. Në veçanti duhet theksuar nxitjen e sjelljes demokratike, ndër të tjerat pranimi i mendimeve tjera, dakordimi dhe qëndrimi prapa rezultatit të përbashkët.

Mësimi i orientuar në veprim

Lojë me rrole

Lojë me rrole p.sh. biseda me klientin te mësimi i orientuar në veprim, është e përshtatshme, në veçanti për të ushtruar mënyrën e sjelljes komunikative dhe sociale.

Loja në rrole përgatitet nga pjesëmarrësit në mënyrë intensive. Secili prej tyre merr një kartë në të cilën është përshkruar roli të cilin duhet luajtur. Për përgatitjen e rroleve duhet planifikuar kohë të mjaftueshme, që secili të njoftohet me rrolit e tij. Një rol të rëndësishëm ka grupi vëzhgues, i cili analizon lojën dhe në fund gjatë diskutimit paraqesin aspektet e tyre.



14: Loja me rrole „Dorëzimi te klienti“

Me shembuj duhet shpjeguar lojën me rrole „Biseda me klientin – dorëzimi te klienti“.

Në fillim përgatitet loja me rrole, në të cilën secili ekip krijon një grup të klientëve (grupin A), një si firma implementuese (grupi B) dhe një grup tjetër si gjyqtarët (grupi C). Fillimisht secili grup përgatitet për bisedën: „Cilat pyetje duhet shtruar?

Çka duhet përcjellur? Cilat dokumente duhet dorëzuar? Si duhet paraqitur?“ Grupi i elektrikistëve duhet të merr pozitën e një laiku. Për të zbatuar lojën të dy grupet ulen në një tavolinë (fig. 14) ose para objektit. Në vazhdim ekipi i parë përfundon lojën në rrole.

Mësimi i orientuar në veprime

Grupi i gjyqtarëve në veçanti vëzhgon paraqitjen e firmës implementuese. Në vazhdim ata japin kritika konstruktive lidhur me bisedën e dorëzimit, të cilat ekipi i dytë duhet marrë parasysh gjatë implementimit të lojës. Përmes lojës së luajtur , kontakti me klientët, pasiguritë e mundshme mund të reflektohen në shkollë dhe të evitohen për më vonë në praktikë.

4.4.3 Fazat e veprimit dhe metodat/mediat (shembuj)


Tabela në vazhdim paraqet një përzgjedhje të metodave/mediave të mundshme në fazat e veçanta të veprimit:

Fazat e veprimit	Metodat / Mediat
Informimi	Zinxhiri i asociimit, Brainstorming, pyetjet, pyetësorët, anketa, pyetje me karta, Mind-Mapping, loja-4-këndëshe, udhëtime fantastike
Planifikimi	Metoda e tophit të borës, plani i aktiviteteve, Metoda 635
Vendimmarrja	Raundi I argumentimeve, matrica e vendimmarrjes, torta e vendimmarrjes, pikët, pyetjet me një pikë, metoda e tophit të borës
Zbatimi	Si funksionon puna në grupe ... , raport I grupit, përmbledhje me shkrim ..., vlerësimi i materialit informativ, sigurimi i informatave përmes ..., protokoll I hulumtimit, proceset & rregullat parimore të prezantimit
Kontrollimi, vlerësimi	Raporte individuale, vlerësimi I punës në grupe
Vlerësimi Reflektimi	Përgjigje e shpejt, shënjestra e vlerësimit, vlerësime me shkrim,

Nga kurrikuli në situatë mësimore

5 Nga kurrikuli i orientuar në qëllimin mësimor në situatë mësimore të orientuar në kompetenca

Koncepti i orientimit në veprim është i përshtatshëm të aplikohet në mësimin në shkollat profesionale. Në kundërshti me këtë qëndrojnë të dhënat e sotme kurrikulare, të cilat, kryesisht janë të ndërtuara në mënyrë sistematike profesionale e jo në mënyrë sistematike vepruese.



15: Situatë mësimore me veprim sistematik¹

¹ Punuar nga Arta Kollçaku, Merita Tahiraj, Naim Hoxha, Besim Hoxha

Nga kurrikuli në situatë mësimore

Gjatë hartimit të kurrikuleve si pikënisje në rend të parë ishin përmbajtjet profesionale me sistematikën e tyre në raport me shkencën e jo veprimi profesional. Këto shkenca kanë ende rëndësinë e tyre në mësimin e orientuar në veprim, mirëpo nuk përcaktojnë strukturën e mësimin. Qëllimet mësimore të kurrikuleve janë të bazuara në përmbajtje të veçanta të profesioneve dhe nuk janë formuluar qëllime tërësisht për krijimin e proceseve gjegj. detyrave të ndërlidhura profesionalisht.


Për të përmbushur zbrazëtirën në mes në mësimin të orientuar në veprim dhe kurrikuleve të orientuara në qëllimin mësimor, do të duhej që plane pune të shkollës të orientuara në kompetenca të krijojnë një urë. Një ekip i mësimdhënësve me aftësi gjithëpërshfshirëse profesionale sjell qëllimet e strukturuar sipas sistematikës profesionale dhe përmbajtjet nga modulet e kurrikulit në një ndërvarësi veprimesh (fig. 15).

5.1 *Plani i punës i shkollës*

Planet e punës shkollore bazohen në kurrikule dhe zhvillimin e kompetencave vepruese e vënë në qendër të mësimin. Ato mundësojnë një precizim të qëllimeve të arsimit profesional në nivel të kompetencave profesionale, personale dhe sociale dhe me këtë nuk bazohen vetëm në përmbajtje profesionale por theksojnë tërësinë.

Ato mbështesin parimin e orientimit në veprim, orientohen në procese ndërmarrësie dhe pune dhe qysh në shkollë mundësojnë një përafrim me profesionin. Ato rishikohen rregullisht dhe me këtë jo vetëm se ofrojnë një përshtatje në profilin e shkollës (p.sh. dispozicioni, dhe kompetencat e personelit, hapësirat, mediat dhe mjetet e punës, partneritete me shkolla, probleme sociale), por edhe në pasqyrën e shkollës. Kështu që në këtë mënyrë merren parasysh edhe ndryshimet e vazhdueshme në fushën profesionale (kualifikimet kyçe, bashkëpunimi me industrinë dhe tregtinë) (fig. 16).

Nga kurrikuli në situatë mësimore



16: Zhvillimi i një plani mësimor

5.2 *Situata mësimore*

Një plan i punës zakonisht përmban më shumë situata mësimore. Këto janë pjesë kurrikulare, të cilat në raport me aplikimin sjellin të paktën përmbajtje teorike profesionale dhe praktike profesionale nga kurrikuli. Plani i punës i shkollës përbëhet nga një plan vështrues me një përshkrim të shkurtër të situatave mësimore dhe renditja e tyre (fig. 17) dhe një përshkrim të detajuar të secilës situatë mësimore (fig.18). Ato janë njësi të përshkruara tematikisht përmes detyrave mësimore, formulimeve të qëllimeve, përmbajtjeve (moduleve), sugjerimeve didaktiko-metodologjike dhe vlerave kohore, të cilat janë të orientuara në shtruarjen e detyrave dhe proceseve vepruese profesionale. Në raste të veçanta mund të parashihen njësi tematike nën pikëpamje profesionale-shkencore, përbrenda situatave mësimore. Gjithsesi se edhe për kësolloj njësisht është e nevojshme të sqarohet ndërvarësia me procesin e punës.

Nga kurrikuli në situatë mësimore

Gjatë hartimit të situatave mësimore, ekipi arsimor do duhej të përgjigjej në pyetjet në vazhdim:

- A janë detyrat motivuese për nxënësit, si për jetën reale ashtu edhe në kontekst profesional?
- Cilat kualifikime gjithëpërfshirëse do duhej të mësoheshin?
- Cilat përmbajtje profesionale-shkencore mund të zhvillohen nga modulet e kurrikulit përkatës?
- A paraqesin detyrat veprime të plota?

SM 1	<u>Vajosja:</u>	
	Detyra :	Të planifikohet dhe zbatohet riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit të vajosjes
	Situata:	Një klient kërkon të bëj kontrollimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të vajosjes për automjetin e tij, VW Passat 1.8.ccm, km 190 000, viti 1991
	Modulet:	B4 – qëllimi i sistemit të vajosjes, llojet dhe veçoritë, vajosja e detyruar, pompat e vajit, filtrat e vajit, radiator C3 – Ndërrimi i vajit dhe filtrit të vajit - Zëvendësimi i nënkarterit të motorrit - Zëvendësimi i pompës së vajit
	Koha	45 h
SM 2	<u>Ftohja</u>	
	Detyra:	të planifikohet dhe zbatohet riparimi dhe sistemi i ftohjes
	Situata:	Një klient i drejtohet shkollës për përgatitjen e automjetit të tij për sezonin dimëror, sistemit të ftohjes për tipin e automjetit Ford Escort 1.6 ccm. viti 1991.
	Modulet	B4 – llojet e sistemit të ftohjes, ndërtimi dhe funksionimi, radiator, pompa e ujit, antifrizi, valvola e termostatit, valvola avull-ajr C4 – Kontrollimi dhe zëvendësimi i lëngut ftohës - Kontrollimi dhe zëvendësimi i termostatit - Kontrollimi dhe zëvendësimi i pompës së ujit
	Koha	36 h

17: Plani i punës së shkollës - plani vështrues²

² I punuar nga Mustafë Ukaj , Enver Osdautaj , Isuf Krasniqi , Bafti Kurti

Nga kurrikuli në situatë mësimore

Situata mësimore	SM2	Koha	36 h
<u>Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ftohjes</u>			
Një klient i drejtohet shkollës për përgatitjen e automjetit të tij për sezonin dimëror, sistemit të ftohjes për tipin e automjetit Ford Escort 1.6 ccm. viti 1991.			
Zhvillimi i kompetencave vepruese profesionale			
<ul style="list-style-type: none"> - Shtjellimi i kërkesave të klientit - Bisedë këshilluese me klientin lidhur me përzgjedhjen e antifrizit, ndërrimin e elementeve të nevojshme - Të punohet në grupe në mënyrë kooperative - Përdorimi i katalogut (librit teknik) - Analiza e funksionimit të sistemit të ftohjes në automjet - Zbatimi i rregullave dhe veprimeve gjatë kontrollimi, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të elementeve në automjet - Dëshmia mbi punën e kryer, ti dorëzohet klientit si dhe llogaria - Vlerësimi i punës në grup - Respektimi i rregullave për mbrojtje në punë dhe ruajtja e mjedisit 			
Përmbajtja profesionale		Nxitjet metodiko-didaktike	
<u>B4- njohuri për automjete</u>		<u>Metodat</u>	
<ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi dhe llojet e sistemit të ftohjes së motorit - Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit të ftohjes me lëng - Radiatori, pompa e ujit, antifrizat - Valvola avull-ajr, termostati 		<ul style="list-style-type: none"> - Ligjërimi i shkurtër - Pyetje zhvillimore - Lojë me rrola - Diskutim 	
<u>C4 – Punime në sistemin e ftohjes</u>		<u>Mediat</u>	
<ul style="list-style-type: none"> - Kontrollimi dhe zëvendësimi i lëngut ftohës - Kontrollimi dhe zëvendësimi i termostatit - Kontrollimi dhe mirëmbajtja e radiatorit - Kontrollimi dhe zëvendësimi i pompës së ujit 		<ul style="list-style-type: none"> - Tabela - Foliet - Grafoskop - Projekto - Mjetet e punës - Libra dhe katalogë të ndryshëm 	
		<u>Mjetet për konkretizim</u>	
		<ul style="list-style-type: none"> - Veglat e punës - Instrumentet matëse - Kompjuteri për diagnostifikim 	

18: Plani i punës së shkollës – Situata mësimore³


³ I punuar nga Mustafë Ukaj , Enver Osdautaj, Isuf Krasniqi , Bafti Kurti

Nga kurrikuli në situatë mësimore

- A nxisin situatat mësimore mësimin e pavarur dhe a kanë parasysh kushtet paraprake individuale për të mësuar?
- Cilat sugjerime metodologjike dhe didaktike i shërbejnë mësimdhënësit që jep mësim?
- Cilat parakushte për të mësuar duhet të kenë përfituar nxënësit nga situatat e mëhershme mësimore (rrjetëzimi i situatave mësimore) ?
- Si është korniza kohore gjegjësisht renditja kohore e situatave mësimore?
- A mund të zbatohen këto situata mësimore në shkollat tona (personat, materiali, hapësirat) apo vetëm me mbështetje të jashtme (partneritete me ndërmarrjet dhe shkollat tjera)?

Në kuptimin e mësimin të orientuar në veprim është kuptimplotë që situatat mësimore të krijohen ashtu që në to të mundësohet një veprim i plotë nga nxënësit.

Nga tërësia e situatave mësimore rezulton kualifikimi profesional. Kështu që në rast ideal situatat mësimore do duhej të ndërtonin njëra mbi tjetrën dhe gjatë kësaj të fitojnë në kompleksitet (fig. 19). Gjithashtu gjatë konstruimit duhet marrë parasysh se me vazhdimin e kohës së shkollimit bie aktiviteti mësimor, për të aftësuar të rinjtë të planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë pavarësisht detyrat në kuadër të aktiviteteve profesionale.



19: Situatat mësimore

Nga situata mësimore në njësi mësimore

6 Nga situata mësimore në njësi mësimore

Në këtë kapitull paraqitet, se si krijohet një njësi e përshtatshme mësimore nga një situatë mësimore. Ky kapitull paraqet vetëm rrugën dhe për këtë arsye nuk është e domosdoshme të jetë i kompletuar.

Fillimisht do duhej që mësimitdhënësi ose ekipi i mësimitdhënësve të analizojnë parakushtet për mësim (fig.20) dhe të zbulojnë se cilat informata mbi nxënësit janë me të vërtetë relevante si bazë për vendimmarrje didaktiko-metodologjike për planifikimin dhe zbatimin e mësimit.

P.sh.


- Numri i nxënësve në klasë
- Shkollimi paraprak, njohuritë paraprake
- Motivimi, aftësitë për punë, aftësitë për komunikim
- Kapaciteti, gatishmëria
- Metodrat dhe forma sociale të përdorura kryesisht
- Analizimi i kompetencave të nxënësve

Për ta zbatuar nevojiten edhe disa kushte të tjera të përgjithshme si p.sh. gjendja e hapësirave, tekste mësimore dhe pajisja e shkollës. Këto janë gjëra që janë marrë parasysh tek plani i punës, por gjithsesi duhet të verifikohen edhe njëherë në këtë moment.

Në varësi të kësaj analize të parë personeli mësimor duhet të vendos se a është e mjaftueshëm situata mësimore në raport me kushtet dhe se sa në segmente (detyra mësimore) do duhej të ndahej ajo.

Në një hap tjetër do duhej që të gjitha detyrave mësimore tu bashkërenditen qëllimet mësimore gjegjësisht kompetencat nga situatat e përzgjedhura mësimore (plani i punës së shkollës). Këto qëllime mësimore pastaj riformulohen për situatën e planifikuar për mësim.

Nga situata mësimore në njësi mësimore



20: Planifikimi i njësisë mësimore

Përzgjedhja e metodave dhe mediave janë të lidhura me intensionet didaktike. Qëllimi vendos për metodën gjegj. mediat. Ndërsa për zgjerimin e kompetencës metodologjike favorizohen metoda të orientuara kah nxënësit, kështu për transmetimin e diturisë mund të përdoren metoda të orientuara kah nxënësit por edhe ato të fokusuara në mësimdhënësin.

Për të pas një vështrim, ora e planifikuar e mësimit paraqitet në formë tabelare në një plan mbi ecurinë e orës mësimore (fig. 21). Modeli i veprimit të plotë e përcakton ecurinë e orës mësimore. Edhe më tutje fazave të veçanta mund tu renditen qëllime/kompetenca, aktivitete të mësimdhënësit/nxënësit, metoda, forma sociale, media dhe eventalisht një kornizë kohore.

Nga situata mësimore në njësi mësimore

1. Situatë mësimore

Krijimi i pjesëve mekanike

Detyra mësimore

Konstruimi i një adapteri , i cili gjindet si element lidhës dhe/ose forcues në mes të bushtit nxitës të një motori elektrik dhe ... të dhëmbëzorit.

2. Kushtet

Mekatronik

3. Kurrikuli


Mekatronik, Moduli 2 dhe Moduli 4, si dhe plani i punës së shkollës

4. Objektivat mësimore dhe kompetencat

- Kompetencat profesionale: Prodhimi i pjesëve mekanike
Zhvillimi i skicave për konstruim me domethënje të plotë
- Kompetencat metodologjike: Pavarësi gjatë përpunimit, krijimit, prezantimit
- Kompetencat sociale: Komunikim dhe bashkëpunim në ekipet
- Kompetencat e personelit: Sjellja e ideve vetanake, aftësia për kritikë

5. Plani mbi ecurinë e orës mësimore

Fazat e mësimimit	Përmbajtje/Objektiva	Mënyrat sociale /e veprimit	Mediat
Informimi	Pasqyrë mbi ecurinë dhe përmbajtjen e orës mësimore	Input i MDH Plenum	Grafoskop Folje
Punë e pavarur produktive (Planifikim, vendimmarrje, zbatim)	Përcaktimi i grupeve dhe shpërndarja e mediave Përpunimi i detyrës: <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi mbi formën e një adapteri funksional • Krijimi i një skice domethënëse dhe me masa • Përcaktimi i një procesi të përshtatshëm të prodhimit/krijimit • Emërtimi i masave për mrojtje në punë gjatë prodhimit të adapterit evtl. Punimi i një plani të punës [ër prodhimin e adapterit (detyrë në vazhdim) 	Punë në grupe	për grup: 1 detyrë pune 1 Motor elektrik 1 Dhëmbëzor 3 Folje 3 Lapsa për folje 1 Matës Letër Lapsa
Shkurt e shpejt (Vlerësimi)	Prezantimi i rezultateve (pjesërrishme) dhe proceseve të punuara deritani nga grupet punuese Mundësi për pyetje nga nxënësit tjerë dhe mësimdhënësi Marrëveshje të punohe me tutje	Plenum	Grafoskop Folje



21: Shembull – koncepti i një njësie mësimore

7 Shtojcë

7.1 Literatura

JANK, W., MEYER, H.

Modelet didaktike - Didaktische Modelle, Berlin 1991-

KONFERENCA E MINSITRAVE TË KULTURËS (HRSG.)

DORACAK PËR PËRPUNIMIN E KORNIZËN E KURRIKULEVE,
[HTTP://WWW.KMK.ORG/DOC/PUBL/HANDREICH.PDF](http://www.kmk.org/doc/publ/handreich.pdf)

INSTITUTI PËR SHKOLLË DHE AFTËSIM TË MËTEJMË NË NIVEL REPUBLIKE (HRSG.)
PRAKTIKA I MËSIMIT TË ORIENTUAR NË VEPRIM – DORACAK PËR PROFESIONET NË
FUSHËN E METALIT DHE ELEKTROS

INSTITUTI REPUBLIKAN PËR EDUKIM DHE MËSIM, STUTTGART
DORACAK, ZBATIMI I RENDITJES SË RE NË FUSHËN E ELEKTROTEKNIKËS,
STUTTGART 2003

NASHAN, R., OTT, B.

PRAKTIKA NË MËSIM TEKNOLOGJIA METALIKE/MAKINERI, PARIMET DIDAKTIKO-
METODOLOGJIKE PËR SHKOLLË DHE NDËRMARRJE, BONN 1995

MINISTRIA E KULTURËS, SAKSONI E ULËT (HRSG.)

MATERIALE PËR FUSHAT MËSIMORE NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË DRURIT,
HANNOVER, SHKURT 2003

MEYER, HILBERT: DORACAK PËR PËRGATITJEN E MËSIMIT
CORNELSEN SCRIPTOR-VERLAG, 1991

OTT, BERND

BAZAT E MËSIMDHËNJES DHE NXËNJES PROFESIONALE, BERLIN 1997

SEIFERT, J.W.

VIZUALIZIMI, PREZANTIMI, MODERIMI, GABAL VERLAG, 12 AUFLAGE, 1998

7.2 Figurat dhe tabelat

1: Aftësia profesionale vepruese.....	5
2: Kualifikimet e përgjithëshme	6
3: Aspekte të mësimit të orientuar në veprim.....	9
4: Veprimi i plotë	11
5: Modeli i veprimit të plotë	12
6: Analiza e sistemit përmes skemës së teknologjisë	13
7: Reflektimi i ecurisë së veprimit	14
8: Fletë pune – Reflektim i punës në grupe	15
9: Porosia e klientit në mësimin e orientuar në veprim	16
10: Shembull i një porosie – instalime elektrike	17
11: Mësim i orientuar në porosi – shkresa e klientit.....	18
12: Krahasimi i teknologjive	22
13: Matricë planifikimi për dorën e nxënësit.....	23
14: Loja me role „Dorëzimi te klienti“	26
15: Situata mësimore sistematike vepruese	28
16: Hartimi i një plani të punës.....	30
17: Plani i punës i shkollës – Plan vështrues.....	31
18: Plani i punës i shkollës – Situata mësimore.....	32
19: Situatat mësimore	33
20: Planifikimi i mësimit.....	35
21: Shembull i një koncepti të njësisë mësimore	37